



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 21.06.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 30.05.2019, 05.06.2019 dhe 11.06.2019.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:12 dhe mbaroi në orën 12:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ilir Toska | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 8. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje ***zonja Naureda Llagami***, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe ***zoti Medi Bici***, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
3. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
5. *Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
6. *Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Ervin Karamuço, ISP.*
8. *Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
9. *Klodian Rado, EURALIUS.*
10. *Erion Fejzulla, USAID.*

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 30.05.2019, 05.06.2019 dhe 11.06.2019.

Maksim Qoku: Atëherë, përshëndetje të nderuar anëtarë!

Fillojmë mbledhjen e radhës të datës 21.06.2019. Mbledhja do të drejtohet përsëri prej meje për shkak të mungesës së Kryetares, bazuar në nenin 60 të ligjit për qeverisjen. Gjithashtu edhe bazuar në nenin 68 të po këtij ligji, verifikojmë kuorumin. Mungojnë dy anëtarë, Kryetarja e cila dihet dhe zoti Medi Bici për faktin që është në të njëjtën orë në një mbledhje pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Meqë kuorumi plotësohet, vazhdojmë me mbledhjen.

Axhenda e sotme përmban 7 pika.

Pika e parë është: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 30.05.2019, 05.06.2019 dhe 11.06.2019.

Pika e dytë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Pika e tretë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur po nga i njëjti Komision.

Pika e katërt është: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”, i përgatitur po nga i njëjti Komision.

Pika e pestë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, i përgatitur po nga i njëjti Komision.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, i përgatitur po nga i njëjti Komision.

Dhe pika e fundit e rendit të ditës: Është caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur edhe ky nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kështu që, duke proceduar me pikën e parë të rendit të ditës, nëse ka diçka nga anëtarët, mund të shprehin ose mund të kalojmë në votim.

Atëherë, kalojmë në votim.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Maksim Qoku: Dakord.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 21.06.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:12 dhe mbaroi në orën 12:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
2. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
3. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
4. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
5. ***Illir Toska*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
8. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje *zonja Naureda Llagami*, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe *zoti Medi Bici*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
- 6. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Ervin Karamuço, ISP.*
- 8. Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
- 9. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 10. Erion Fejzulla, USAID.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Atëherë, kalojmë në pikën e dytë. Fjala është për një nga anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për zotin Toro.

Zoti Toro, ju lutem!

Alban Toro: Po, faleminderit!

Atëherë, në një vendim më të parshëm, ky Këshill, me vendimin nr. 89, datë 17.06.2019, filloi procedurat e transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e dy pozicioneve të lira për transferim të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Në respekt të Rregullores përkatëse, nga ana jonë është kërkuar opinion i kryetarëve përkatës të gjykatave përkatëse nga të cilat vijnë këta gjyqtarë, të cilët janë përgjigjur në mënyrë pozitive faktit që këta gjyqtarë të vazhdojnë transferimin. Gjithashtu kemi vazhduar me kriterin e dytë i cili është marrja e pëlqimit gjyqtarëve, e cila është një nga kriteret bazë të kësaj Rregulloreje dhe po ashtu, këta gjyqtarë janë përgjigjur pozitivisht, kanë shprehur pëlqimin për të vazhduar transferimin e përkohshëm në gjykatat ku ato janë caktuar në mënyrë të përkohshme.

Në të njëjtin kuadër edhe zonja gjyqtare {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, ka dhënë pëlqimin për vijimin e transferimit të përkohshëm edhe për një periudhë tjetër 1-vjeçare.

Kështu që, në këtë kontekst, Komisioni ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimin përkatës, në bazë të të cilit gjyqtare {...}, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, i përsëritet transferimi i përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë për një periudhë deri në 1 vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Maksim Qoku: Okej! Ka diskutime? Opsione?

Nëse jeni dakord, mund ta kalojmë në votim?

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Maksim Qoku: Dakord.

Atëherë, miratohet përsëritja e transferimit për gjyqtaren {...}.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 21.06.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:12 dhe mbaroi në orën 12:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ilir Toska | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 8. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje *zonja Naureda Llagami*, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe *zoti Medi Bici*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
- 6. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Ervin Karamuço, ISP.*
- 8. Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
- 9. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 10. Erion Fejzulla, USAID.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës. Shqyrtimin e projektvendimit për gjyqtarin {...}.

Fjala për ju, zoti Toro!

Alban Toro: Po, faleminderit!

I njëjti ‘modus operandi’ është përdorur edhe për gjyqtarët në vijim përfshirë edhe zotin {...}. Në respekt të Rregullores përkatëse për transferimin e përkohshëm si dhe vendimit të mëparshëm të Këshillit, pra vendimit nr. 89, 17.06.2019 “Për fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e dy pozicioneve të lira për transferim të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, është vijuar së pari me marrjen e pëlqimit nga ana e gjyqtarëve respektivë si dhe marrjen e një opinionit nga

kryetarët e gjykatave të cilat këta gjyqtarë vijnë. Nga të dy palët janë dhënë pëlqimi përkatës dhe në këtë kontekst, Komisioni ka propozuar dhe projektin përkatës, i cili konsiston: Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i përsëritet transferimi i përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri në 1 vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë si dhe Gjykatës së Rrethit Korçë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen e internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Maksim Qoku: Faleminderit, zoti Toro!

Nëse nuk ka diskutime, kalojmë në votim?

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

(Vota e zonjës Luli nuk dëgjohet.)

(Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohet.)

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Maksim Qoku: Dakord.

Atëherë, miratohet transferimi edhe për gjyqtarin {...}.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 21.06.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:12 dhe mbaroi në orën 12:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ilir Toska | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 8. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje *zonja Naureda Llagami*, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe *zoti Medi Bici*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
- 6. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Ervin Karamuço, ISP.*
- 8. Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
- 9. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 10. Erion Fejzulla, USAID.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, për sa i përket {...}.

Zoti Toro!

Alban Toro: Po, faleminderit!

Bazuar në vendimin nr. 88, datë 17.06.2019 “Për fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”, Këshilli ka shpallur një pozicion të lirë për transferim të përkohshëm në këtë gjykatë, duke ngarkuar më pas Komisionin për të vijuar me procedurat e mëtejshme. Në kuadër të respektimit të procedurës përkatëse,

kemi kërkuar pëlqimin përkatësisht të gjyqtarit {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat si dhe, të kryetarit përkatës të po kësaj gjykate.

Pasi është marrë pëlqimi nga të dy palët, kemi përgatitur projektin përkatës të vendimit, në bazë të të cilit gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, i përsëritet transferimi i përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës deri më datën 15.09.2019. Gjyqtari {...} të përjashtohet nga shorti gjatë periudhës së transferimit të përkohshëm deri më datën 15.09.2019 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, me përjashtim të çështjeve urgjente në kuptim të nenit 2, shkronja /c/ e ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, për të cilat duhet të përfshihet në short deri më datë 31.08.2019. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Maksim Qoku: Faleminderit, zoti Toro!

Nëse nuk ka diskutim nga anëtarët, mund të kalojmë në votim.

Brikena Ukperaj: Atëherë, referuar deklaratës për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm, gjyqtari {...}, në shkresën që i bashkëngjitet, duket që ka dhënë pëlqim për Gjykatën Kurbin dhe Kavajë dhe jo për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

(Nga anëtarët përgjigjet që zoti {...} ka dhënë pëlqim për të tre gjykatat.)

Okej! Më fal! Nuk e pashë. Tërhiqem!

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

(Vota e zonjës Luli nuk dëgjohet.)

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Maksim Qoku: Dakord.

Atëherë, miratohet transferimi i gjyqtarit {...} për në Kukës për afat 3-mujor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 21.06.2019)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:12 dhe mbaroi në orën 12:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ilir Toska | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 8. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje **zonja Naureda Llagami**, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe **zoti Medi Bici**, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.**
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.**
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.**
- 6. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Ervin Karamuço, ISP.**
- 8. Klara Kodra, Qendra Evropiane.**
- 9. Klodian Rado, EURALIUS.**
- 10. Erion Fejzulla, USAID.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Kalojmë në çështjen tjetër, në lidhje me gjyqtaren {...}.

Fjala për ju, zoti Toro!

Alban Toro: Faleminderit, përsëri!

Atëherë, më herët, me vendimin nr. 87, 17.06.2019 “Për fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, ky Këshill, pasi ka miratuar shpalljen e një pozicioni të lirë, i ka ngarkuar Komisionit përkatës që të vijojë me procedurat e tjera, të cilët bazuar në Rregulloren për transferim të përkohshëm konsistonin në marrjen e pëlqimit së pari të gjyqtarit përkatës i cili është transferuar dhe

të kryetarit nga i cili ky gjyqtar vjen. Të dy palët, pasi kanë shprehur pëlqimin, na kanë mundësuar pastaj të vijojmë me vijimin e procedurës së caktimit të këtij gjyqtari për transferim të përkohshëm në këtë gjykatë, duke përcaktuar edhe projektin përkatës, i cili konsiston në: Gjyqtares {...}, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, i përsëritet transferimi i përkohshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, për një periudhë deri në 1 vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Maksim Qoku: Faleminderit, zoti Toro!

Nëse anëtarët nuk kanë gjë, mund të kalojmë në votim edhe për këtë gjyqtare.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Maksim Qoku: Dakord.

Atëherë, kalon miratimi i transferimit edhe për gjyqtaren {...}.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 21.06.2019)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:12 dhe mbaroi në orën 12:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ilir Toska | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 8. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje *zonja Naureda Llagami*, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe *zoti Medi Bici*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
- 6. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Ervin Karamuço, ISP.*
- 8. Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
- 9. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 10. Erion Fejzulla, USAID.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Vazhdojmë çështjen tjetër, me projektvendimin për përsëritjen e transferimit në Gjykatën Administrative Shkodër. Fjala për ju, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Po! Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 91, datë 17.06.2019 “Për fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë për transferim të përkohshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, vendosi fillimin e kësaj procedure, autorizimin e Komisionit për të vijuar më tej me fazat e procedurës së transferimit dhe kërkimin e pëlqimit gjyqtarit që është aktualisht i transferuar në këtë gjykatë, zotit {...}, pëlqim ky i cili u kërkua deri më 15.09.2019. Iu

kërkua pëlqimi zotit {...}, i cili me shkresën 3317 protokolli, ka dhënë pëlqimin e tij lidhur me këtë transferim. Ndërkohë i është kërkuar pëlqimi edhe kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, pra gjykatës ku zoti {...} është i emëruar në mënyrë të përhershme. Zonja {...}, kryetare e kësaj gjykate ka pasqyruar situatën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, të cilën ne tashmë e dimë, por për të gjithë ato arsye që përmendëm në mbledhjen e mëparshme, Komisioni çmoi që transferimi i zotit {...}, vijimi i tij në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, do të sillte një dobi më të madhe se sa efekti negativ që ai krijon në gjykatën ku ai është i caktuar në mënyrë të përhershme. Por pavarësisht nga kjo, zonja {...} ka shprehur pëlqimin edhe ajo, për vijimin e transferimit të zotit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për periudhën për të cilën Këshilli ka rënë dakord.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës çmon t'i propozojë Këshillit të Lartë Gjyqësor që: Gjyqtarit {...}, t'i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, deri më datë 15.09.2019. Gjyqtari {...} të përjashtohet nga shorti i çështjeve gjyqësore gjatë periudhës së transferimit të përkohshëm, deri më datë 15.09.2019, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, me përjashtim të “çështjeve gjyqësore urgjente” në kuptim të nenit 2, shkronja /c/, të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, për të cilat duhet të përfshihet në short deri më datë 31.08.2019. Ky vendim t'i njoftohet gjyqtarit {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Maksim Qoku: Faleminderit, zonja Shehu!

Nëse nuk ka objeksione, mund të kalojmë në votim.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Maksim Qoku: Dakord.

Atëherë, miratuam edhe transferimin ose përsëritjen për gjyqtarin {...}.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 21.06.2019)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:12 dhe mbaroi në orën 12:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ilir Toska | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 8. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje **zonja Naureda Llagami**, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe **zoti Medi Bici**, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. **Rudin Baqli**, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. **Vildan Kaloshi**, Drejtor pranë institucionit.
3. **Krisulla Kasaj**, Përgjegjëse pranë institucionit.
4. **Elis Kuçi**, Specialist pranë institucionit.
5. **Valbona Bako**, Specialiste pranë institucionit.
6. **Edlira Bako**, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.
7. **Ervin Karamuço**, ISP.
8. **Klara Kodra**, Qendra Evropiane.
9. **Klodian Rado**, EURALIUS.
10. **Erion Fejzulla**, USAID.

RENDI I DITËS:

7. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Kalojmë në çështjen e fundit të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore.

Zoti Toska, fjala për ju!

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, përgjatë këtyre 4 ditëve, nga mbledhja e mëparshme, pranë Këshillit kanë mbërritur disa kërkesa, një pjesë e të cilave janë të karakterit të ngutshëm, arsye për të cilën ne konsideruam si Komision i Zhvillimit të Karrierës t’i propozojë Këshillit për të

bërë disa caktime të gjyqtarëve për çështje gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme. Referuar kërkesave, janë 6 gjykata në nevojë, për një apo për më tepër çështje gjyqësore dhe kemi propozuar edhe këtë radhë shortin që duhet të ndiqet. Fillimisht Gjykata e Apelit për Krime të Rënda. Më pas gjykata e apelit me juridiksion të përgjithshëm, ajo e Vlorës. Më tej gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm sipas juridiksionit të gjykatës së apelit, sipas kësaj radhe: fillimisht gjykatat nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, më pas Mat dhe në fund Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më tej shorti të vijojë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, që është vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Jeni dakord me radhën e shortit?

Maksim Qoku: Atëherë, votimi bëhet me dorë.

Jemi të gjithë dakord.

Ilir Toska: Atëherë, do të vijojmë për secilën nga gjykatat në nevojë procedurat e shortit.

Atëherë, gjykata e parë në nevojë për të cilën do të bëj procedurat e shortit është ajo e **Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda**. Kërkesa që është paraqitur nga kjo gjykatë referon për nevojën e një çështjeje penale dhe për një gjyqtar. Në rastin konkret, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës konsideron se zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit të gjyqtarit është i pazbatueshëm për sa kohë nuk ka në këtë skemë gjyqtarë. Ndërkohë që është e padobishme zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu rasti për të vijuar me zbatimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në kuadër të të cilit kemi propozuar që Këshilli të mbajë në konsideratë edhe disa procedura të tjera të shortit të ndjekura nga Këshilli në datat 20.05.2019, 05.06.2019 dhe 17.06.2019, që kanë të bëjnë po për të njëjtën çështje gjyqësore, kjo sa i përket përjashtimit të gjyqtarëve. Kemi konsideruar që të përjashtohen... duhet të përfshihen në short të gjithë gjyqtarët që kemi propozuar të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, duke përjashtuar këta gjyqtarë: kryetarët apo kryetarët në detyrë të

gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, që janë gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}; anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi: gjyqtarët {...} dhe {...}; gjyqtarit që i është akorduar leja afatgjatë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor {...} dhe {...}; gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Apelit Tiranë, që janë gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}; gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë që është në prag të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë, zoti {...}, si dhe gjyqtarët që janë në procedim penal përpara juridiksionit të gjykatave të krimeve të rënda, domethënë edhe në atë të gjykatës në nevojë në rastin konkret: gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}.

Përveç këtyre, sikundër kemi propozuar edhe më herët, duhet të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë që është identifikuar që ka pengesë ligjore për gjykimin e çështjes në rastin konkret, zonja {...}. Përveç saj, do duhet të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, znj. {...} që është caktuar më herët nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në këtë çështje gjyqësore. Po ashtu duhen përjashtuar nga shorti edhe dy gjyqtarët e gjykatës me juridiksion të përgjithshëm që janë edhe anëtarë të Kolegjit Zgjedhor, i cili është aktualisht i mbledhur, që janë zoti {...} dhe zoti {...}. Ndërkohë që zoti {...}, përveçse është anëtar i Kolegjit Zgjedhor, është edhe kryetari në detyrë në Gjykatën e Apelit Shkodër. Jeni dakord me këtë ripropozim që bëmë?

Maksim Qoku: Atëherë, me dorë.

Dakord të gjithë?

Ilir Toska: Do duhet të sqaroj se në materialet e mbledhjes është edhe një kërkesë e gjyqtarit {...}, i seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, përmes së cilës gjyqtari {...} ka kërkuar që Këshilli ta përjashtojë nga shorti për gjykimin e kësaj çështjeje, me arsyetimin se ka papajtueshmëri sipas tij, për të marrë/për të gjykuar çështjen.

Opinionin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është se ne nuk mund të përjashtojmë nga çështja gjyqtarë të caktuar, nuk është në kompetencën e Këshillit. Kërkesa mund të shqyrtohet vetëm nga një organ gjyqësor. Në rast se ka dorëheqje, duhet ta trajtojë kryetari i gjykatës përkatëse ose në rast se ka kërkesë për përjashtim, duhet ta shqyrtojë gjyqtari që ngarkon ligji për shqyrtimin e saj.

Brikena Ukperaj: Referuar kërkesës së gjyqtarit {...}, pavarësisht se, në fakt baza ligjore procedurale është e gabuar, që është neni 15, 17 i Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit gjyqtari duhet të paraqesë kërkesën për dorëheqje para kryetarit të gjykatës, në fakt, referuar përmbajtjes së kërkesës, ai kërkon që të përjashtohet nga shorti për shkak se për të njëjtat shkaqe gjyqtare {...} ka dhënë dorëheqjen dhe është përjashtuar. Referuar edhe akteve që bashkëngjiten. Për të mos e futur... sepse në qoftë se ky gjyqtar do t'i binte çështja përsëri, ai do të paraqiste kërkesë për heqje dorë dhe referuar të njëjtit precedent, sepse ka qenë pjesë e trupit gjykues, për të njëjtin shkak që gjyqtare {...} është përjashtuar, ai do të përjashtohet sepse është për të njëjtin shkak.

Aktualisht, duke i konsideruar të gjithë gjyqtarët që kanë qenë pjesë e trupit gjykues, të mos i fusim përsëri në short.

Dakord. Është e njëjta gjë në qoftë se për shembull për një masë sigurimi një gjyqtar ka dhënë dorëheqjen dhe vjen këtu çështja për delegim gjyqtari dhe gjyqtarët e tjerë automatikisht duhet të jenë përjashtuar. E kuptoj merakun që pse bëhet fjalë për heqje dorë të gjyqtarit sipas neneve 15 dhe 17 të Kodit të Procedurës Civile por kjo do të ishte, në qoftë se do ta përjashtonim, do të ndihmonte procesin...

Dakord. Gjithsesi, si ta mendoni!

Ilir Toska: E vetmja gjë që dua të them është që Këshilli nuk është organ i pushtetit gjyqësor. Këshilli merret me mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor dhe nuk ka asnjë kompetencë gjyqësore të përjashtojë apo të pranojë dorëheqjet e gjyqtarëve për çështje konkrete. Nuk mundet Këshilli të marrë dhe të vlerësojë nëse është rasti motamo si një rast tjetër. Është kompetencë e organeve gjyqësore që duhet të vlerësojnë rrethana të caktuara të faktit. Këshilli, mbase për oportunitet, mund të zgjedhë këtë, por do duhet të marrë kompetenca që nuk i ka. Këshilli mund të përjashtojë nga shorti vetëm për shkak ngarkese, për shkak sëmundjeje apo për shkak shpërndarje të barabartë të çështjeve. Nuk ka asnjë kompetencë Këshilli të vlerësojë nëse një gjyqtar duhet apo s'duhet të marrë pjesë në një çështje gjyqësore konkrete. Ky është problemi.

Brikena Ukperaj: Me këtë logjikë ne kemi përjashtuar nga shorti edhe gjyqtarë të tjerë, siç mund të jenë gjyqtarët e apelit civil, gjyqtarët që janë në KED. Ideja është që...

Ilir Toska: Atëherë, gjyqtarët që kemi propozuar të përjashtohen nuk kanë të bëjnë me çështje konkrete, kanë të bëjnë me ngarkesën e punës. Gjyqtarët e KED-së kanë ngarkesë shtesë. Gjyqtarët e seksionit civil janë për lëndë. Në rastin konkret i referohemi një lëndë penale. Nuk ka të bëjë me rastin konkret, domethënë me çështje individuale që lidhen me rastin konkret.

Maksim Qoku: Mendime të tjera?

Kalojmë në votim?

Brunilda Kadi: Do hidhet në votë propozimi i Komisionit?

Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Alban Toro: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Maksim Qoku: Dakord.

Ilir Toska: Vijojmë me procedurat e shortit. Hedhim në një enë emrat e të gjithë gjyqtarëve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, duke përjashtuar të gjithë ata që thamë më herët që përjashtohen nga shorti.

Fillojmë me gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Vazhdojmë me gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë: {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Vazhdojmë me Gjykatën e Apelit Gjirokastrë: {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Gjykata e Apelit Durrës: {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Vazhdojmë me Gjykatën e Apelit Korçë: {...} dhe {...}.

E fundit është Gjykata e Apelit Shkodër: {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Atëherë, përzgjedhim emrat e të gjithë që janë në enë.

Hajde ta përzgjedhë Elisi.

{...} është emri i gjyqtarit që përzgjidhet nga shorti.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Mirë, vazhdojmë procedurat e shortit për **Gjykatën e Apelit Vlorë**. Është paraqitur kërkesë dhe ka nevojë për 1 çështje gjyqësore të veçantë për caktimin e një gjyqtari. Në këtë rast nuk është i zbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërkohë që është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, prandaj bëhet i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Në këtë kuadër, kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhet me short gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet, të jetë 1. Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)

Mirë atëherë, meqenëse Këshilli është dakord. Kemi propozuar që nga shorti të përjashtohet vetëm kryetari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, zoti {...} si dhe gjyqtari që është edhe në Kolegjin Zgjedhor, zoti {...}. Jeni dakord edhe me këtë propozim të dytë?

(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)

Maksim Qoku: Dakord të gjithë.

Ilir Toska: Vazhdojmë me procedurat e shortit atëherë.

Futim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër që janë: {...}, {...}, {...}, {...}. Do duhet të përzgjedhim njërin prej tyre – {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Vlorë.

Vijojmë me gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Fillimisht është **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin**. Ka paraqitur nevojë në 4 çështje. 3 çështje penale dhe 1 çështje civile. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërkohë që është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Në konsideratë të këtij vendimi, kemi propozuar që gjykata nga duhet të

përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa numri i gjyqtarëve dhe do caktohen për gjykimin e këtyre 4 çështjeve, të jetë 4. Ndërsa kërkohen minimalisht 3 gjyqtarë në çështjet penale dhe 1 gjyqtar në çështjen civile.

Në këtë rast kemi propozuar që të përjashtohen nga shorti, në rast se pranohet propozimi i parë, gjyqtarja e seksionit penal e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë znj. {...} që është me leje lindje. Po kështu të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e seksionit penal të themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e tre apo më tepër çështje gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, që janë gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe zoti {...}. Ndërsa sa i përket shortimit të çështjes civile do përjashtohet nga shorti gjyqtari Arben Mullai, që kemi marrë vendim për ta përjashtuar për një periudhë 6-mujore nga shortet. Po kështu të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata, të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, që janë gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe zoti {...}. Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)

Atëherë, vijojmë procedurat e shortit.

Fillimisht do të shpërndajmë për 3 çështjet penale, për të cilat kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarëve të seksionit penal të çështjeve penale të themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur i pari është automatikisht edhe relator i çështjes.

Do të hedhim në një enë, emrat e të gjithë gjyqtarëve të seksionit penal të themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që janë {...}, {...}, {...} dhe {...}. Duhet të përzgjedhim 3 prej tyre. I pari që do të përzgjidhet është edhe relator i çështjes.

{...} është emri i parë (relator). {...} është emri i dytë dhe {...} është emri i tretë.

Vazhdojmë procedurat e shortit për çështjet penale nr. 1 dhe nr. 2 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Për secilën nga ato gjyqtari të përzgjidhet me short midis 2 gjyqtarëve të seksionit penal të çështjeve penale të themelit të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Tiranë të caktuar si anëtarë për çështjen penale nr. 2. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur i pari, caktohet për çështjen e renditur e para në listë. Do të fusim në një enë emrat e dy gjyqtarëve {...} dhe {...}. I pari do të caktohet për çështjen nr. 1 dhe i dyti për çështjen nr. 2.

Emri i parë që përzgjidhet është {...}, që caktohet për çështjen nr. 1.

Dhe për çështjen nr. 2 mbetet të caktohet gjyqtari {...}.

Me kaq mbyllet procedura e shortit për çështjet penale.

Kemi edhe çështjen civile, atë me nr. 4, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të seksionit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke hequr gjyqtarët që u përjashtuan nga shorti më herët.

{...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...},
{...}, {...}, {...} dhe {...}.

{...} është emri i gjyqtarit të përzgjedhur nga shorti, që caktohet për çështjen civile nr. 4. Me kaq mbyllet procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka paraqitur nevojë për 1 çështje penale dhe kërkohet 1 gjyqtar. Në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërkohë që është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në kuadër të të cilit kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë 1. Në këtë rast, kemi propozuar të përjashtojmë nga shorti vetëm kryetaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, zonja {...}. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)

Vazhdojmë atëherë me procedurat e shortit.

Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, që janë {...} dhe {...}. Do të përzgjedhim njëren prej tyre që do caktohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat - {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur nevojë në 1 çështje civile, kërkohet 1 gjyqtar. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në kuadër të të cilit kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, ndërsa numri i gjyqtarit që duhet të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje, të jetë 1, aq sa kërkohet. Në këtë rast kemi propozuar të përjashtohet nga shorti, kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, zonjë {...} si dhe gjyqtari që më herët u caktua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat. Ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vetëm 3 gjyqtarë, një prej të cilëve kryetare, një gjyqtar u caktua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, zonja {...}, dhe ngelet vetëm gjyqtarja {...} që duhet të caktohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)

Mirë, atëherë mbyllen edhe procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

E fundit është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje gjyqësore me lëndë penale dhe kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në zbatim të të cilit kemi propozuar

që gjykata nga duhet të përzgjidhet me short gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1, aq sa kërkohet. Edhe në këtë rast kemi propozuar të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, zoti {...}, po kështu të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtarja {...}, e cila në shortin e përpara katër ditëve datë 17.06.2019 është caktuar për disa çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord.)

Atëherë, hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të tjerë që janë {...}, {...}. Dy emra janë. Do të përzgjedhim emrin e njëres prej gjyqtarëve për të ta caktuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Emri i përzgjedhur është {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe të gjithë shortet. Faleminderit!

Maksim Qoku: Faleminderit, zoti Toska!

Me kaq mbyllen/ezaurohen çështjet e rendit të ditës. Kështu që nëse nuk ka gjë tjetër, e mbyllim. Faleminderit!

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor